

RREGULLORE NR. 2006/57

**PËR SHPALLJEN E LIGJIT MBI MBROJTJEN NGA ZJARRI TË
MIRATUAR NGA KUVENDI I KOSOVËS**

Ushtruesi i detyrës së Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm,

Në pajtim me autorizimin që i është dhënë me Rezolutën 1244 (1999) të Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara të datës 10 qershor 1999,

Në përputhje me kapitullin 5.1 (i) dhe (m), 5.5 (b) dhe nenin 9.1.26 (a) të Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë (Rregullorja e UNMIK-ut nr. 2001/9, maj 2001),

Duke marrë parasysh shkresën zyrtare nga Kryetari i Kuvendit të Kosovës të datës 18 prill 2006 lidhur me Ligjin mbi mbrojtjen nga zjarri të miratuar nga Kuvendi i Kosovës më 6 prill 2006,

Duke vërejtur se dispozitat e Ligjit nuk e cenojnë autorizimin e Përfaqësuesit Special të Sekretarit të Përgjithshëm sipas RKSKB 1244 (1999) apo kompetencat dhe përgjegjësitë e tij të rezervuara sipas Kornizës Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë,

Me anë të kësaj shpall Ligjin për mbrojtjen nga zjarri të miratuar nga Kuvendi i Kosovës (Ligji nr. 02/L-41), që i është bashkëngjitur kësaj Rregulloreje dhe i cili bëhet i plotfuqishëm nga data e nënshkrimit, me kusht që fjala “kundërvajtje” kudo që paraqitet në kapitullin 10 të zëvendësohet me fjalën “shkelje”; dhe në nenin 55 fjalët “ose burgim” dhe “i mitur” të fshihen.

Këto ndryshime do të paraqiten në tekstin përfundimtar zyrtar të Ligjit.

E nënshkruar sot, më 20 dhjetor 2006.

Joachim Rücker
Përfaqësues Special i Sekretarit të Përgjithshëm